VENDIM
Nr.877, datë 3.11.2010

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN SI REZULTAT I REALIZIMIT TË REZERVUARIT GRUMBULLUES TË UJËRAVE TË SHIUT, KORÇË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik" dhe të nenit 8, të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken si rezultat i realizimit të rezervuarit grumbullues të ujërave të shiut, Korçë

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ujësjellës-Kanalizimeve sh.a., Korçë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen e përgjithshme 3500 (tremijë e pesëqind) m^2, tokë truall, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 65 579 500 (gjashtëdhjetë e pesë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në shumën 343 500 (treqind e dyzet e tre mijë e pesëqind) lekë të përballohen nga Ujësjellës-Kanalizime sh.a., Korçë.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 65 579 500 (gjashtëdhjetë e pesë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind) lekësh, të përballohet nga "Llogaria e veçantë" e Ministrisë së Financave pranë Bankës së Shqipërisë "Fondi i shpronësimeve".

6. Shpronësimi të fillojë më 1.11.2010 dhe të përfundojë më 1.2.2011.

7. Ujësjellës-Kanalizime sh.a., Korçë, të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi

8. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP-ja, Korçë (bashkëpronësi)", të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Ujësjellës-Kanalizimeve sh.a., Korçë.

9. Ujësjellës-Kanalizime sh.a., Korçë, të kryejë likuidimin e pronarëve, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP-ja, Korçë, (bashkëpronësi)", pasi ata të kenë dorëzuar dokumentacionin e plotë të pronësisë.

10. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Ujësjellës-Kanalizime sh.a., Korçë, të fillojë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t'i vihet në dispozicion nga Ujësjellës-Kanalizime sh.a., Korçë, si dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

11. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

12. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Nr.i zonës kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. truall m^2	Çmimi lekë/m^2	Vlera lekë	Vlera totale lekë	Shënime
1	Petraq Pendavinji	8561	11/36	913	18.737	17.106.881	17.106.881	Konfirmuar nga ZRPP-ja
2	Teneqexhi e Xharo	8561	11/68	2587	18.737	48.472.619	48.472.619	Konfirmuar nga ZRPP-ja
						Totali	**65 579 500**	

Adresa: "Vasil Tromara", lagjja 12, nr.15, Korçë.
Pasuria me nr.11/68 është në pronësi të 18 bashkëpronarëve si më poshtë:

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Adresa
1	Katerina Teneqexhi	Rr. "Koço Stralla" lagjja 11, nr.16 Korçë
2	Natasha Sotir Teneqexhi	Rr. "28 Nëntori" lagjja 16, Pall.3 Korçë
3	Petraq Sotir Teneqexhi	Rr. "Koço Stralla" lagjja 11, nr.16 Korçë
4	Rozeta Sotir Teneqexhi	Rr. "Koço Stralla" lagjja 11, nr.16 Korçë
5	Elisaveta Sotir Teneqexhi	Rr. "Koço Stralla" lagjja 11, nr.14 Korçë
6	Anesti Kiço Teneqexhi	Shëtitorja "Fan Noli" lagjja.5, pall.nr.26, shk.A/5 Korçë
7	Ilia Kiço Teneqexhi	Shëtitorja "Fan Noli" lagjja.5, pall.nr.26, shk.A/5 Korçë
8	Keti Kiço Teneqexhi	Rr. "Koço Stralla" lagjja 11, nr.14 Korçë
9	Romeo Kiço Teneqexhi	Rr. "Ali Visha" Ap.18, shk.2 Korçë
10	Kostanca Petro Xharo	Rr. "Ptolemeu Xhuvani" lagjja 1, Korçë
11	Thoma Petro Xharo	Rr. "Alqi Kondi" lagjja 3, nr.1 Korçë
12	Robert Petro Xharo	Rr. "Alqi Kondi" lagjja 3, nr.1 Korçë
13	Dhimitraq Koço Teneqexhi	Rr. "Pano Xhamballo" lagjja 10, pall 16 H/c-2 Korçë
14	Pandeli Koço Teneqexhi	Rr. "Pano Xhamballo" lagjja 10, pall 16 H/c-2 Korçë
15	Irini Koço Teneqexhi	Rr. "Pano Xhamballo" lagjja 10, pall 16 H/c-2 Korçë
16	Ipathia Ili Teneqexhi	Rr. "Koço Stralla" lagjja 11, nr.6 Korçë
17	Kozeta Gaqo Teneqexhi	Rr. "Koço Stralla" lagjja 11, nr.6 Korçë
18	Dhori Gaqo Teneqexhi	Rr. "Koço Stralla" lagjja 11, nr.6 Korçë